

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

**Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kz. Nr. 250/2011  
Prishtinë  
12 qershor 2012**

**Gjykata Supreme e Kosovës mbajti seancën e kolegjit në pajtueshmëri me Nenin 26 paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), dhe Nenin 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhja e Lëndëve dhe Caktimi i Lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK), më 11 qershor 2012 në ndërtesën e Gjykatës Supreme në kolegin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar i kolegjit, gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës Salih Toplica, Nesrin Lushta dhe Marije Ademi si anëtarë të kolegjit,**

Dhe me Zyrtarin Ligjor të EULEX-it Holger Engelmann si procesmbajtës,

Në praninë e

Prokurorit Publik Judit Tatrai, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK)

Avokatit mbrojtës Skender Musa për të pandehurin ██████████ ✓.

Përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar znj. S██████████ Q██████████ Av. Jakup Gurmani

Në lëndën penale AP-KZ 250/2011 kundër të pandehurit:

██████████, i lindur më ██████████ në fshatin Kocilar, komuna e Titovo Veles në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (IRJM). adresa e fundit e njohur e banimit ██████████ biri i ██████████ i nënës ██████████, dñe shkrim dhe lexim, ka të mbaruar tete vjet të shkollës fillore, punëtor fizikë, me gjendje ekonomike mesatare, i martuar, baba i dy fëmijëve, vazhdimi i shëndetit që nga 6 gusht 2010,

Në pajtueshmëri me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren në lëndën me nr. P. Nr. 160/2010, të datës 23 mars 2011 dhe i regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prizren të njëjtën ditë, i **pandehuri është shpallur fajtor**:

Sepse më 09 gusht 1999 në një vend të panjohur në mes të Prizrenit dhe Karaçicës, komuna e Shtimës, duke vepruar për përfitim personal, konsistoi në marrjen e veturës së

viktimës, një Audi 80 me ngjyrë të kuqe me targa 183 – KSD – 207, dhe i pandehuri privoi nga jetë [REDAKTUE] eshtrat e të cilit u gjetën më 10 korrik 2002 në fshatin Karaçicë, pra i pandehuri ka kryer veprën penale Vrasje në pajtueshmëri me Nenin 30, par. 2 nën paragrafi 3 të Ligjit Penal të Krahanës Socialiste Autonome të Kosovës (LPK) në lidhje me Nenin 38, paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ),

**Dhe u dënuar me 17** (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim nga data 06 gusht 2010 deri më 23 mars 2011, por duke liruar atë nga detyra e kompensimit të tërësishëm të shpenzimeve të procedurës penale.

**Avokati mbrojtës** i të akuzuarit në kohë ushtroi ankesë më datën 08 qershor 2011 kundër të aktgjykimit. Është theksuar se aktgjyki përmban shkelje esenciale të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të kodit penale dhe se dënim i shqiptuar kundër të akuzuarit duhej të kundërshtohej. Është propozuar të prishet aktgjyki dhe të lirohet i pandehuri si i pafajshëm apo të kthehet lënda në të njëjtën gjykatë për rigjykim dhe rivendosje.

**Përfaqësuesi i palës së dëmtuar** përmes ankesës me shkrim më datën 06 qershor 2011 ka ankimuar në kohë aktgjykin po ashtu, duke qenë i pakënaqur me vendimin për dënimin, pasi që dënim i do të ishte shumë i ulët dhe prandaj jo i duhur në krahasim me fajësinë e gjetur.

**Prokurori Publik i Qarkut në Prizren** në kohë ka ankimuar aktgjykin më datë 10 qershor 2011 në lidhje me sanksionin penal, pasi që gjykata ka dështuar të shqyrtoj të gjitha rrëthanat relevante kur ka përcaktuar shkallën e dënit. Është propozuar që për shkak të mungesës së rrëthanave lehtësuese, por duke pasur parasysh praninë e rrëthanave rënduese, dënim i duhet të ngritet në 20 vjet burgim.

**ZPSH<sub>K</sub>**, me përgjigjën e datës 10 janar 2012 dhe të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës në të njëjtën ditë, ka kundërshtuar aktgjykin e shkallës së parë për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të fakteve dhe vlerësim të gabuar të provave. Është propozuar të vlerësohet nëse gjykata e shkallës së parë ka përbushur obligimin e saj të ngritur nga parimet e supozimit të pafajësisë, *in dubio pro reo* dhe *favor rei*.

Bazuar në aktgjykin me shkrim në lëndën P, Nr. 160/10 të Gjykatës së Qarkut në Prizren të datës 25 mars 2012 (parashtruar nga Shkrimoren e asaj gjykatës në njëjtën ditë), ankesën me shkrim e parashtruar nga avokati mbrojtës në emër të të pandehurit, ankesat e palës së dëmtuar përmes përfaqësuesit të saj ligjor dhe e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, mendimin e ZPSH<sub>K</sub> si edhe shkresat relevante të lëndës, parashtresat gojore të palëve gjatë seancës dëgjimore më 11 qershor 2012, së bashku me analizën e ligjit në fuqi, Gjykata Supreme e Kosovës, pas këshillimit të mbajtur më 11 qershor 2012, lëshon këtë:

## **AKTVENDIM**

- (1) Ankesa e avokatit mbrojtës e paraqitur në emër të të pandehurit [REDACTED] kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren P. Nr. 160/2010, të datës 23 mars 2011, PRANOHET. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ANULOHET dhe lënda KTHEHET PËR RIGJYKIM dhe vendim. S. V.
- (2) Ankesat e prokurorisë dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar kundër aktgjykimit të lartë përmendur janë jo lëndore.
- (3) Kërkesa e avokatit mbrojtës në emër të të pandehurit [REDACTED] për të ndërpërë paraburgimin REFUZOHET SI E PABAZUAR. S. V.

## **ARSYETIMI**

### **Historia e procedurës**

Më 03 qershor 2008, Prokurori Publik i Qarkut në Prizren ka lëshuar aktvendimin mbi fillimin e hetimit (HP nr.143/08) kundër të pandehurit [REDACTED] për veprën penale të Vrasje e Rëndë (me qëllim të fitimit të dobisë pasurore) në pajtueshmëri me Nenin 147 paragrafi 7 të Kodit të Përkoħshiēm Penal të Kosovës, e dënueshme me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet apo burgim afatgjatë (ekuivalent me Nenin 30 të LPK ).

Më 27 prill 2009, gjyqtari i procedurës paraprake ka lëshuar dy aktvendime të ndara me të cilat ai refuzoi kérkesën për arrestimin e të pandehurit dhe kérkesën për paraburgim kundër tij, ndërsa me 08 maj 2009 gjyqtari i procedurës paraprake të EULEX-it i Gjykatës së Qarkut në Prizren, duke vendosur sipas propozimit të Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren për vazhdimin e hetimeve, vendosi të vazhdoj paraburgimin kundër S. V. deri më 02 qershor 2009.

Më 20 maj 2009 koleksi prej tre gjyqtarë i të njëjtës gjykatë prishi aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake për të refuzuar arrestimin e të pandehurit dhe e ktheu kérkesën te gjyqtari i procedurës paraprake përi ri shqyrtim. Ankesa kundër aktvendimit mbi paraburgimin është hedh poshtë si e vonuar. Rrjedhimisht, gjyqtari i procedurës paraprake lëshoi urdhëresë për arrestim kundër të pandehurit më 28 maj 2009 dhe – të njëjtën ditë – pranoi vazhdimin e hetimit kundër tij deri më 02 dhjetor 2009.

Prokurori i Qarkut të EULEX-it ka lëshuar aktvendimin për pezullimin e hetimeve kundër të pandehurit më 09 korrik 2009.

Më 29 shtator 2009 sipas kérkesës së Prokurorit të Qarkut të EULEX-it dhe në pajtueshmëri me Nenin 544 dhe 547 të KPPK, gjyqtari i procedurës paraprake ka

paraqitur një kërkesë për dhënien e Letër Reshtimit ndërkombëtar kundër të pandehurit te Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP), e cila u lëshua më 22 tetor 2009.

Më pas, më 12 qershor 2010 i pandehuri u arrestua në pikën kufitare Bajakova në Kroaci; Prokurori i Qarkut të EULEX paraqiti kërkesë më datën 22 qershor 2009 në Ministrinë e Drejtësisë të Kosovës duke kérkuar transferimin e [REDACTED] të Kosovë, sipas të cilës i pandehuri u ekstradua në Kosovë më 06 gusht 2010. S.V.

Më 06 gusht 2010 Prokurori i Qarkut në Prizren rifilloj hetimet kundër S. [REDACTED] i cili – pas dëgjimit nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprakë më 07 gusht 2010 – u dërgua në paraburgim.

Më datë 10 shtator 2010 Prokurori Publik i Qarkut përsiti aktakuzën (HP. Nr. 143/08; HEP nr. 118/08) kundër të pandehurit [REDACTED] për vepër penale të Vrasje në pajtueshmëri me Nenin 30 paragrafi 2 pika 3 të LPK në pajtueshmëri me Nenin 38 paragrafi 2 të KP RSFJ, e cila u konfirmua nga gjyqtari për konfirmim më 04 tetor 2010.

Pas ankimit të pasuksesshëm të aktakuzës, si edhe aktvendimit të konfirmimit nga i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës, Gjykata e Qarkut në Prizren ka filluar shqyrtimin gjyqësor përmes gjithsej tetë seancave dëgjimore më 09, 10 dhjetor 2010, 24, 25 janar, 4 shkurt, 17, 21 dhe 23 mars 2011, ku në të fundit u shpall aktgjykimi i kundërshtuar. Me një aktvendim të veçantë paraburgimi i të pandehurit u vazhdua derisa aktgjykimi të merr formë të prerë.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë ka marrë në pyetje të akuzuarin, [REDACTED]. Pastaj, janë marrë në pyetje edhe këta dëshmitarë: [REDACTED] (09 dhjetor 2010), [REDACTED] (24 janar 2011) [REDACTED] (10 dhjetor 2010), [REDACTED] (25 janar 2011), [REDACTED] (04 shkurt 2011) [REDACTED] (17 mars 2011).

Përveç kësaj, provat nga shkresat në vijim janë marrë parasysh dhe janë lexuar në pajtueshmëri me Nenin 368 paragrafi 3 të KPPK: një përbledhje e vendit të ngjarjes përpiluar nga Policia e Kosovës më 17 mars 2005; skica e vendit ku janë gjetur eshrat e viktimit [REDACTED] nga [REDACTED] konfirmimi i identitetit i lëshuar nga Zyra për Personat e Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore (ZPZhML) më datë 05 dhjetor 2002; raporti i autopsisë EX2002-126 nga ZPZHML (FZX01/001BP/MPU 2000) (identifikimi i mbetjeve mortore të viktimit); informatat e Sistemit Informativë të Veturave të Kosovës në lidhje me veturën Audi 80 me ngjyrë të kuqe në emër të pronarit [REDACTED] datës 15 janar 2004; kontrata mbi blerjen e Audi 80 përkatëse në mes të viktimit [REDACTED] dhe pronarit të parë të veturës, [REDACTED] datës 17 korrik 1998; kontrata mbi blerjen e Audi 80 përkatëse në mes të [REDACTED] si kompanisë [REDACTED] datës 20 nëntor 2001; dokumentet e regjistrimit të makinës Audi 80 me ngjyrë të kuqe; fotografitë e makinës Audi 80 të kuqe, të bëra nga Policia dhe dokumentet e dërguara nga Zyra e Regjistrimit të Veturave në Ferizaj.

Bazuar në gjetjet e saj, më 23 mars 2011, Gjykata e Qarkut shpalli aktgjykimin dhe gjeti të pandehurin fajtor për veprën penale Vrasje në pajtueshmëri me Nenin 30 paragrafi 2 nën-paragrafi 3 të LPK në lidhje me Nenin 38, paragrafi 2 të KP të RSFJ sikurse është theksuar më lart. Si pasojë, gjykata ka shqiptuar ndaj të akuzuarit dënimin i cili po ashtu është specifikuar më lart.

**Avokati mbrojtës i të akuzuarit në kohë ka ushtruar ankesën më datën 08 qershor 2011 kundër aktgjykimit, ai pohoj dhe propozoj sikurse u përmend edhe më parë.**

**Përfaqësuesi i palës së dëmtuar** me anë të ankesës me shkrim më datën 06 qershor 2011 në kohë ka ankimore aktgjykimin po ashtu, duke mos qenë i kënaqur me vendimin për dënimin, sikurse u theksua më lart.

**Prokurori Publik i Qarkut në Prizren** në kohë ka kundërshtuar aktgjykimin më 10 qershor 2011 në lidhje me sanksionin penal, sikurse u përmend më lart.

**ZPShK**, me përgjigjen e datës 10 janar 2012 ka kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së parë për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të fakteve sikurse edhe u vë në pah më sipër.

### **GJETJET E GJYKATËS**

Gjykata Supreme konstaton se aktgjykimi i kundërshtuar dhe vlerësimi i provave i bëre nga Gjykata e Qarkut në Prizren jep shumë arsyë për të anuluar aktgjykimin dhe për të dërguar lëndën mbrapa për rishqyrtim. Megjithatë këtu duhet të theksohen vetëm problemet kryesore të aktgjykimit të kundërshtuar, e që janë reflektuar në dy hapësirat e rishqyrtimit, d.m.th shkelje substancial e dispozitave të Procedurës Penale dhe vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike.

#### **A. Shkelje esenciale të dispozitave të Procedurës Penale**

##### **I. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 403 PARAGRAFI 1 PIKA 8 TË KPPK:**

Avokati mbrojtës i të pandehurit [REDACTED] [REDACTED] i një pikë të caktuar i mbështetur nga mendimi i ZPShK - ka theksuar se i pandehuri është shpallur fajtor pa konfirmuar fajësinë e tij me prova materiale, që në fakt nuk ka pasur asnjë provë materiale që ndërlidhë të pandehurin me krimin me të cilin ai ishte akuzuar. Në vend të kësaj, aktgjykimi i kundërshtuar do të bazohej në deklaratat e dëshmitarëve të ngatërruara të tilla si ajo nga dëshmitari [REDACTED] sipas indikacioneve të tilla sikurse mungesa e një kontrate me shkrim për blerje në mes të viktimitës dhe të pandehurit lidhur me automjetin, por pa i marrë parasysh kushtet specifike në Kosovë gjatë periudhës

kohore, kur vrasja e viktimës ka ndodhur gjoja. Prandaj, do të shkelet Neni 403 paragrafi 1 pika 8 të KPPK.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se referimi i avokatit mbrojtës në Nenin 403 paragrafi 1 pika 8 të KPPK është jo meritor sepse nuk mund të vërtetohet asnjë indikacion se prova të cilës ai i referohet e gjykatës së shkallës së parë është e papranueshme.

II. SHKELJE E SUPOZUAR E NENIT 403 PARAGRAFI 1 PIKA 12 TË  
KPPK:

S. ✓

Për më tepër, avokati mbrojtës i [REDACTED] theksuar se dispozitivi i aktgjykit të kundërshtuar të shkallës së parë do të jetë në kundërthënie me përbajtjen e tij, pasi që baza vendimtare dhe faktet, se si, kur dhe ku pikërisht është kryer krimi i supozuar, nuk u paraqitën në pjesën arsyetuese. Në vend të kësaj, dispozitivi i aktgjykit të kundërshtuar do të bazohet plotësisht në deklaratat e dëshmitarëve të caktuar, ndërsa nga ana tjetër gjykata nuk kishte arritur të ftojë dhe të dëgjojë dëshmitarët e tjerë, të cilët do të kishin deklaruar në favor të të pandehurit. Në veçanti, dëshmitarët [REDACTED] janë dëgjuar nga gjykata. Prandaj do të shkelet Neni 403 paragrafi 1 pika 12 të KPPK.

Gjykata Supreme në vend të parë konstaton se në të vërtet shkresat e lëndës përbajnjë indikacione të shumta të forta për të pandehurin të përfshirë në zhdukjen (dhe ndoshta edhe vdekjen) e viktimës [REDACTED]. Shumë nga këto indikacione janë adresuar edhe nga aktgjyki i kundërshtuar, të tillë si se i pandehuri [REDACTED] se ka shoqëruar viktiminë gjoja në udhëtimin e tij të fundit më 09 gusht 1999 nga Prizreni në Prishtinë në Audi 80 me ngjyrë të kuqe të viktimës, që më vonë është gjetur në posedim të të pandehurit. Për më tepër, hetimet kanë vërtetuar se i pandehuri ishte mjaft i njohur me terrenin, ku eshtret e viktimës janë gjetur më vonë. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se i pandehuri gjoja se ka qenë mik i mirë dhe i afërt me viktiminë në atë kohë, kur ai u shtrua në spital dhe menjëherë më pas, por nuk u interesua fare përsëri në lidhje me vendndodhjen e viktimës, pas zhdukjes së [REDACTED] më 09 gusht 1999. Sipas deklaratës të të pandehurit më 17 mars 2011 në Gjykatën e Qarkut në Prizren, ai ishte në dijeni për zhdukjen e viktimës për herë të parë në vitin 2004, kur ai u arrestua nga Policia. Në lidhje me shqyrtimin e Gjykatës Supreme, çështja e pasurisë së të pandehurit në gusht të vitit 1999 mund të jap një tregues për një motiv të mundshëm të të akuzuarit për të dëmtuar viktiminë dhe për të marrë makinën e tij, por është e një rëndësi dytësore, duke qenë se të dyja, çmimi të cilin i pandehuri dyshohet se e ka paguar për automjetin e viktimës si edhe çmimi të cilin më vonë ai e ka kërkuar për blerësit e tjerë është mjaft i ulëta.

Megjithatë, Gjykata Supreme gjen se as për afër nuk janë vërtetuar hollësitë e vrasjes së [REDACTED] nga ana e Gjykatës së Qarkut. Edhe pse kjo e fundit në përgjithësi nuk eshte e domosdoshme për të vërtetuar kryerjen e vrasjes nga kryerësi i caktuar, në rast të

mungesës së provave të drejtpërdrejta që lidhin kryerësin me krimin zinxhiri i provave rrethanore dhe indikacionet duhet të mbyllen. Kjo nuk është dhënë në rasatin konkret.

Gjykata e shkallës së parë ka bazuar mendimin e saj mbi dy argumente kryesore se vetëm i pandehurit [REDAKTUE] mundur ta vriste viktimën gjatë rrugës për në Prishtinë më 09 gusht 1999. Gjykata e Qarkut, në bazë të arsyetimit të aktgjykimit të kundërshtuar, ka arritur deri te "përfundimi i pashmangshëm se kryerësi i vrasjes së [REDAKTUE] është i pandehurit [REDAKTUE] i ishte personi i fundit që e ka parë të gjallë viktimen" (faqe 17 e aktgjykimit te kundërshtuar në versionin e tij në gjuhën angleze). Gjykata e Qarkut më pas vazhdon me interpretimin e dëshmisë së dëshmitarit A [REDAKTUE], sipas së cilës një ditë para incidentit i pandehuri duke u kthyer nga fshati Zatriq gjatë ndaljes në një restorant në Malishevë i ka "thënë dëshmitarit në ditën pasuese do të shkojë në Prishtinë [REDAKTUE] ta marrë veturën e tij dhe ta përfundojë me të sepse [...] nuk ishte njeri i mirë" (faqe 8, 12 dhe 17 e aktgjykimit të kundërshtuar të versionit në gjuhën angleze).

Gjykata e Qarkut më pastaj vien në përfundim shtesë siç është dashja e të pandehurit për ta vrarë viktimën [REDAKTUE] ishte nënvizuar nga i pandehuri dukë mos lejuar A [REDAKTUE] të shkonte me të dhe me viktimën në Prishtinë më 09 gusht 1999, pasi që i pandehuri kishte qëllimin të mos ketë asnjë dëshmitar me të atë ditë. Duke u bazuar në këtë, Gjykata arrin në përfundim se i pandehuri thjesht ka gënjer kur deklaroi se viktima u largua me dy ose tre persona të tjera.

Gjykata e Qarkut është dashur së paku të vlerësojë provat kundërthënëse dhe të përfshijë në arsyetimin e aktgjykimit pse i është bindur njërit version të asaj çka kinse ka ndodhur në ditën kritike, e jo versionit tjetër. Në veçanti, gjykata e shkallës së parë ka bërë një analizë me kujdes të provave (faqe 9-16 e aktgjykimit të kundërshtuar të versionit në gjuhën angleze), që megjithatë nuk reflektohet plotësisht në vlerësimin e përgjithshëm të provave siç përmendet në faqe 17-18 të këtij aktgjykimi.

#### **1. Pyetja se sa persona kishin shoqëruar viktimën në udhëtimin e tij të fundit:**

Gjykata e Qarkut nuk i ka dhënë shumë rëndësi dëshmisë së dëshmitarit [REDAKTUE] pronarit të pompës së benzinës [REDAKTUE] në mes Prizrenit dhe Gjakovës, i cili mendon se ka parë viktimën së bashku me dy persona të tjera në veturën e tij Audi 80, pasi që dëshmitari më nuk ishte i sigurt për ditën e saktë të asaj që kishte parë. Megjithatë, Gjykata e Qarkut ka vërtetuar si gjetje faktike se "[viktima] shkoi për Prishtinë me veturën e tij Audi 80, ngjyrë të kuqe, me numër të shasisë WAUZZZ8AZLA000130, me tabela nr. PE 660-22 bashkë me të pandehurin [REDAKTUE] he së paku një person të tretë" (faqe 8 e aktgjykimit të kundërshtuar të versionit në gjuhën angleze).

Vërtetë, dëshmia përkatëse e dëshmitarit [REDAKTUE] mbështetet nga dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUE] gruas së viktimës, te dhënë më 09 dhjetor 2010 para gjykatës (faqe 6 dhe 7) si dne para policisë, sipas së cilës dëshmitarët [REDAKTUE] he [REDAKTUE] kishin thënë asaj se më 09 gusht 1999 burri i saj ishte nisur per ne Prishtinë së

bashku me dy persona të tjerë, [REDACTED] dhe [REDACTED] Vlen të përmendet përkitazi me këtë se gruaja e viktimës [REDACTED] konkretisht njozu emrin e J. M. [REDACTED], i cili para policisë së UNMIK-ut pranoi se ishte ushtar aktiv i UÇK-së nga viti 1998, por mohoi se kishte operuar ndonjëherë në zonën e Prizrenit dhe se pas luftës iu kishte bashkuar TMK-së. Ky fakt bashkë me faktin se [REDACTED] Vjenështe marrë në pyetje dy herë nga policia, një herë më 21 janar 2001 dhe herën tjeter më 25 mars 2002, në të dy rastet nga Policia e UNMIK-ut dhe se bazuar në protokollin e Stacioni të Policisë së UNMIK-ut në Prizren të datës 25 janar 2001 hetimet lidhur me vendndodhjen e J. M. [REDACTED] kishin filluar për shkak të përmendjes së tij nga ana e ankueses dhe dëshmitares S. C. [REDACTED] është dashur ta shtyjet Gjykatën e Qarkut së paku ta ftojë dhe ta dëgjojë atë si dëshmitar. Njashtu hedhja një sy shënimive të tij në TMK me qëllim të kuptimit cilat ishin detyrat e tij në kohën kritike do të ndihmonin në ndriçimin e rolit të tij në këtë ngjarje.

Edhe pse Gjykata e Qarkut nuk i besoi shumë dëshmisë së dëshmitarit [REDACTED] ishte dhënë para gjykatës, po ashtu edhe ky dëshmitar ka folur lidhur me viktimen [REDACTED] ai kishte shkuar me dy persona të tjerë në ditën kritike (dëshmja e dëshmitari të datës 25 janar 2011, faqe 14 dhe 16).

Megjithatë, gjykata e shkallës së parë asnjëherë nuk humbi kohë përkitazi me pyetjen se kush ka mundur të ishte personi i tretë dhe nëse ka ekzistuar mundësia që ai person i tretë të ketë marrë pjesë në krimin e pretenduar. Nuk është marrë as iniciativë për të dëgjuar J. M. [REDACTED] si dëshmitar ose për të bërë hetime kundër tij. Në vend të kësaj, aktgjykimi i kundërshtuar lidhur me këtë thotë se “[gruaja] e viktimës nuk e ka ditur se bashkë me kë kishte shkuar burri i saj në Prishtinë në ditën kritike [...] dhe se...] kinse ajo kishte marrë këtë informatë më vonë”. Prandaj, “[dëshmja] e kësaj dëshmitareje nuk solli asnjë njoħuri të rëndësishme për përcaktimin e gjendjes faktike [...]” (faqe 13 e aktgjykimit të kundërshtuar të versionit në gjuhën angleze).

## 2. Interpretimi i deklarimit të të pandehurit për ta ‘marrë’ veturën e viktimës për ta ‘përfunduar me të’:

Gjykata e Qarkut ka bazuar aktgjykimin e vet kryesisht në dëshmitë e dëshmitarit [REDACTED] ishte dhënë gjatë shqyrtimit më 10 dhjetor 2010, sipas së cilës i pandehuri, gjatë një pauze në një restoran në Malishevë, i kishte thënë dëshmitarit se në ditën pasuese (më 09 gusht 1999) “ai do të shkojë me [REDACTED] në Prishtinë, do ta marrë veturën e tij dhe do ta përfundojë me të, sepse [...] [REDACTED] nuk është njeri i mirë”.

Gjykata e Qarkut ka interpretuar dëshminë e këtij dëshmitari në atë mënyrë sikur se i pandehuri në këtë rast ka deklaruar dashjen e tij për ta vrarë viktimen me qëllim që t’ia marrë veturën, duke mos përfillur interpretimin e dëshmitarit, sipas ti cilit i pandehuri donte të shprehte se do ta përfundonte negocimin me viktimen pér blerjen veturës së tij. Edhe pse interpretimi dhe vlerësimi përfundimtar i fakteve është nën diskrecion të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Qarkut në rastin konkret nuk ka arritur ta analizoje

me kujdes dëshminë e dëshmitarit dhe t'i diskutojë interpretimet e tjera të mundshme në bazë të provave të tjera (rrethanore) në dispozicion.

Pavarësisht nga fakti se sipas dëshmitarit [REDACTED] viktima gjatë rrugës për Prishtinë kishte thënë se dëshironte te shiste veturën dhe se i pandehuri iu kishte përgjigjur se do t'ia gjente një blerës, veçanërisht procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 17 mars 2011 flet shumë lidhur me këtë çështje. Megjithatë, nuk reflektohen plotësisht në aktgjykimin e kundërshtuar. Gjatë rrjedhës së këtij shqyrtimi, i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës në disa raste kanë theksuar se i pandehuri kishte blerë veturën nga viktima, Audi 80 ngjyrë të kuqe, dhe në këmbim ai i kishte dorëzuar viktimës 2.100 euro në "Café Kosova" afër spitalit në Prizren. Një person me emrin [REDACTED] i cili pretendohet se jeton në Ferizaj të cilin i pandehuri e njihite me emër dhe dukje, ishte dëshmitar i kësaj procedure. Për më shumë, i njëjti [REDACTED] kishte qenë i pranishëm, kur viktima pasi ia kishte shitur veturën të pandehurit, ishte larguar nga ai vend në shoqërimin e dy ose tret personave të tjera të panjohur për të pandehurin. Edhe pse hollësitë në këtë kontekst janë shumë të mjegullta gjykata, duke qenë e obliguar ta vërtetojë fajësinë e të pandehurit, ka mundur ta shtyjet të pandehurin dhe avokatin e tij mbrojtës të gjejnë vendndodhjen e dëshmitarit të pretenduar [REDACTED] me qëllim që ai të merrej në pyetje para gjykatës.

### 3. Inspektimi i vendit

Nevoja për t'i vërtetuar detajet se si ka ardhur deri te vdekja e viktimës ka rëndësi dhe peshë të madhe. Është tejet e rëndësishme të vërtetohet ose së paku diskutohet nëse [REDACTED] është vrarë/ka vdekur në vendin ku një pjesë e mbetjes së tij (femuri) është gjetur mbi një gur afër fshatit Karaqicë dhe në rast se ka vdekur diku tjetër, nëse ka qenë e mundur që i pandehuri ta transportojë trupin e tij tek guri përkatës afër fshatit Karaqicë, ose me makinë ose duke ecur dhe na pasur asnjë dëshmitarë. Në lidhje me këtë duhet të merret parasysh se i pandehuri [REDACTED] A në atë kohë gjoja i është nënshtuar një operacioni në këmbë vetëm katër ditë para dhe prandaj ka mundur të jetë ndikuar nga gjendja e tij shëndetësore dhe aftësia e tij për të ecur dhe vendosja e peshës në këmbën e tij të lënduar. Pasi që jo vetëm shkresat e lëndës si të tillë por gjithashtu edhe një kërkim në Google Earth tregon se zona përreth fshatit Karaqicë është e vëtmuar dhe rurale madje edhe sot, inspektimi i vendit ku janë gjetur mbetjet e viktimës siç është propozuar nga avokati mbrojtës i të pandehurit në seancën e mbajtur më 17 mars 2011, ka mundur të ofroj sqarime lidhur me lëndën.

## B. Motivi

Pse i pandehuri ka pasur qëllim të vras një njeri të cilin e ka njoftuar gjersa ka qenë i hospitalizuar i cili vetëm e ka mbështetur dhe ndihmuar të pandehurin, i ka gjetur vendbanim të pérhershëm, të shoqërohet me të dhe të shkojnë së bashku në kafene gati pér çdo ditë dhe i cili në disa rast i ka ofruar të pandehurit udhëtime me makinë, pasi që ky i fundit nuk ka pasur makinë? Mund të imagjinojen versione të shumta: A ka qenë i pandehuri i udhëhequr nga laktmia sa që ka dashur ta privoj viktimin ngajeta vetëm sa pér të marrë veturën e tij (pér të cilën shumë persona kanë ditur se që nga viti 1998 makina ka qenë e viktimës dhe ka qenë e regjistruar në emër të tij)? A ka qenë urrejtja etnike ajo që e ka bërë të pandehurin të vendosë që ta vrasë viktimin pasi që e ka kuptuar se viktima i ka takuar komunititet Torbesh? A i ka dorëzuar i pandehuri paratë viktimës në shkëmbim të veturës siç është përshkruar gjatë shqyrtimit gjyqësor më 17 mars 2011, por pastaj ka udhëtar prapa me të dhe e ka privuar ngajeta në mënyrë që përsëri t'i marrë paratë dhe ta mbajë veturën? Ose a kanë ekzistuar dy apo tre persona të ligë të panjohur siç është përshkruar nga i pandehuri më 17 mars 2011, me të cilët viktima ka dalë nga kafeneja pas shijes së veturës te i pandehuri? Dhe nëse po, a ka mundur të jetë motiv gjithashtu edhe pér ata që ta vrasin viktimin pasi që kanë vërejtur se viktima ka pranuar një shumë të madhe të parave nga i pandehuri?

Edhe pse është plotësisht e quartë pér Gjykatën Supreme se shumica dërmuese e këtyre pyetjeve nuk mund të përgjigjen përfundimisht më pasi që ka kaluar një kohë e gjatë që nga incidenti në fjalë, Gjykata e Qarkut së paku ka pasur pér obligim që t'i diskutoj ato dhe të jap një arsyetim të duhur se pse situata dhe në lidhje me pjesëmarjen dhe përgjegjësinë e të pandehurit lidhur me krimin e pretenduar është interpretuar në atë mënyrë siç është cekur në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar, dhe jo në mënyrë tjetër – gjithashtu të mundshme

## C. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

S. ✓

Avokati mbrojtës [REDACTED] theksuar se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të gabuar pasi që nuk e ka marrë parasysh se në kohën e Vrasjes së pretenduar të viktimës, gjendja shëndetësore e të pandehurit nuk ka qenë e mirë. Në veçanti i pandehuri në atë kohë është dashur të ecë vetëm me paterica, gjë që do t'ia pamundësonë atij që ta bartë viktimin (të gjallë apo të vdekur) rrëth 7-8 kilometra nga rruga deri në fshatin Karaqicë, ku në vitin 2002 janë gjetur mbetjet e viktimës the. Përveç kësaj, gjykata e shkallës së parë nuk ka sqaruar në çfarë rrëthana viktima është pretenduar ngajeta dhe si është kryer Vrasja e pretenduar. Gjithashtu, gjendja financiare e të pandehurit është dashur të vlerësohet më në detaje në kohën e zhdukjes së [REDACTED]. Si duket i pandehuri, në kundërshtim të asaj që është vërtetuar nga Gjykata e Qarkut në Prizren ka pasur para më se të mjaftueshme pér ta blerë veturën nga viktima. Prandaj, nen 405 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së janë shkelur.

Referencë e plotë i është bërë asaj që tanimë është theksuar nën pikë A të këtij aktgjykimi. Vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike tanimë është reflektuar me një arsyetim jo të plotë dhe kundërthënës të aktgjykimit të kundërshtuar siç është shtjelluar më parë.

Edhe pse Gjykata Supreme e Kosovës ka theksuar disa herë se në këtë kontekst Gjykata Supreme e Kosovës ka theksuar se fillimi i provave si rregull është në diskrecion të gjykatës së shkallës së parë (lënda *Runjeva, Akgami dhe Dema* (Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZ 477/05 e datës 25 janar 2008, faqe 20) dhe shumë të tjera më vonë), kjo nuk e pengon gjykatën e shkallës së parë që të bëjë një vlerësim të duhur, kujdeshëm, të plotë, dhe analizës së të gjitha provave, qofshin ato prova të drejtpërdrejta apo vetëm rrethanore.

#### **D. Shkelja substanciale e ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin**

Edhe pse avokati mbrojtës i të pandehurit [REDACTED] ka kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së parë me pretendim në shkelje të ligjit penal, që të dy avokati mbrojtës në njërin anë dhe përfaqësuesi ligor i palës së dëmtuar dhe Prokurori i Qarkut në Prizren në anën tjetër kanë theksuar se nuk janë të kënaqur me dënimin e shqiptuar, Gjykata Supreme nuk e sheh nevojën që të shkohet më thellë në këto pretendime, duke pasur parasysh se shkeljet e vërtetuara më parë domosdoshmërisht gjithashtu shpien në rivlerësimin edhe të këtyre aspekteve të aktgjykimit të kundërshtuar.

Në bazë të arsyeve të lartpërmendura Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv.

#### **Anëtarët e kolegji:**

---

**Marije Ademi**  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

---

**Nesrin Lushta**  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

**Elka Filcheva-Ermenkova**  
Gjyqtare e EULEX-it  
Republika e Kosovës  
Republika Kosovo

SAKTÉSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAÇNUST UPRAVKA POTVRUJUJE

*[Signature]*

H. [Signature] autorizuar  
**Safim Toplica** [Signature]  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

**Kryetar i kolegjit:**

Procesmbajtës

---

**Gerrit-Marc Sprenger**  
Gjyqtar i EULEX-it

---

**Holger Engelmann**  
Zyrtar ligjor i EULEX-it

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**Ap.-Kž. Nr. 250/2011**  
**Prishtinë**  
**12 qershor 2012**

**Këshillë juridike**

Sipas nenit 431 paragrafit 4 të KPPK-së, nuk lejohet ankesë kundër këtij aktvendimi.